

VENDIM
Nr. 2469, datë 25.4.2025

PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT TË SHOQËRISË
“BELLE AIR” SHPK

SHKURTIM VENDIMI

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR: Ervin Pollozhani,

asistuar nga sekretare gjyqësore Silvana Marku, sot, më datë 25.4.2025, shqyrtoi në seancë gjyqësore publike, çështjen civile-tregtare, me nr. 10332/1267/379/235/171/140/126/119/102/97/92/83 regj. themeltar, që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “BELLE AIR” sh.p.k., me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga znj. Shpresa Breçani, me cilësinë e administratores së falimentimit të shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k.

OBJEKTI: Mbyllje e procedurës së falimentimit të shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, i ndryshuar; neni 163 i tij.

Gjykata, pasi administroi provat shkresore, dëgjoi administratoren e falimentit znj. Shpresa Breçani, e cila u shpreh për përfundimin e procedurës së falimentimit, për shkak të likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjen e të ardhurave të kreditorët e falimentit, anëtarët e Komitetit të Kreditorëve, që ishin dakord me mbylljen e kësaj procedure, ndërsa anëtari i Komitetit të Kreditorëve, si përfaqësues i aeroportëve, z. Ervin Bano, ishte dakord me mbylljen e procedurës, porse e la në çmim të gjykatës çregjistrimin e shoqërisë, si e shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë debitore “BELLE AIR” sh.p.k. me NIPT K51817001T, me seli në adresën: rruga “Jordan Misja”, pallati “Sara-El”, shkalla 1, apartamenti 1, Tiranë, Shqipëri, me objekt të veprimtarisë së saj në fushën e transportit ndërkombëtar të personave, mallrave, postës, me çdo lloj mjeti transporti ajror, për shkak të likuidimit të të gjithë pasurisë së saj dhe shpërndarjes së të ardhurave, duke e shpallur si shoqëri e falimentuar.

2. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k. nga regjistri tregtar i shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k. nga organet tatimore, si dhe nga të gjitha organet apo institucionet në të cilat është e regjistruar.

4. Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të debitorit, shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

5. Urdhërohet publikimi i këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në adresën zyrtare në internet të këtij institucioni, në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

6. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

7. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

8. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “BELLE AIR” sh.p.k. t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si dhe Degës së Doganës Tiranë.

9. Një kopje e vendimit për mbylljen e procedurës së falimentimit të debitorit, shoqërisë “BELLE AIR” sh.p.k., bashkë me raportin përfundimtar të administratores së falimentimit Shpresa Breçani, t’i komunikohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për verifikimin e konsumimit të veprave penale në fushën e shoqërive tregtare dhe të falimentimit.

10. Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentimin.

11. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 ditëve, afat ky që fillon sipas ligjit.

12. U shpall sot, më datë 25.4.2025, në Tiranë, ora 14:55.

SEKRETARE
Silvana Marku

GJYQTAR
Ervin Pollozhani

Shënim. Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua më datë 9.6.2025.
Tiranë, më datë 11.6.2025.